



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNË

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe vendimit të Kuvendit nr. 33, dt.14.04.2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, Enti Rregullator i Ujit shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin:

Sekretare e Kryetarit dhe Komisionit Kombëtar, Enti Rregullator i Ujit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Ndaj tij të mos jenë marrë masa disiplinore për largimin nga puna, për shkak të shkeljeve disiplinore dhe cënim të rregullave të etikës nga një subjekt tjetër punëdhënës;
- f) Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për pozicionin përkatës sipas kriterëve të miratuara nga KKRR;
- g) Të mos ketë lidhje familjare me anëtarët e KKRR-së apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- h) Të zotërojnë diplomë të nivelit DND
- i) Të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune
- j) Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
- k) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe me aftësi shumë të mira të punës në grup.

Kandidatët duhet të paraqesin në zyrën e protokollit të ERRU këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim;
- Curriculum Vitae në gjuhën shqipe;
- Kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara;
- Dokumente zyrtare që vërtetojnë njohjen e gjuhëve të huaja;

- Certifikata të kualifikimeve të ndryshme çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Librezë pune (fotokopje të noterizuar) ;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Certifikatën e Gjendjes Gjyqësore ose formularin e vet deklarimit të gjendjes gjyqësore;
- Formularin e vet deklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” ;.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Dokumentat do të dorëzohen pranë Entit Rregullator të Ujit deri më datën **26.05.2025**, ora **16:30**, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Rr. "Viktor Eftimiu", Ndërtesa nr. 1, Kati IV, Njësia Administrative nr. 5, 1022. Tiranë.